



**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 02, datë 17.03.2021

**PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA BELSH, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 1, DATË 27.02.2019
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT**

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 1, datë 27.02.2019 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Belsh”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Belsh, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Bashkisë Belsh Nr. 14 datë 26.02.2021, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Belsh të miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 27.02.2019, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të bëhen ndryshime në dokumentin e:

- *Rregullores së Planit:*

- *Pas pikës 3.1 shtohet pika 3.1/1 “Rregullat për zhvillimet në sistemet Urban, Bujqësor dhe Natyror”;*
- *Pas pikës 7.1.2 shtohet pika 7.1.2/1 “Rastet për të cilat hartimi i PDV-së nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm”;*
- *Tabelat e treguesve të zhvillimit të njësive strukturore.*

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Belsh, bashkëlidhur këtij Vendimi.

2. Ngarkohen Bashkia Belsh dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


BELINDA BALLËKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT


LEDIA TOTA



3. Ngarkohen Bashkia Belsh, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDL RAMA

